



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2026



Komuna e Kaçanikut

PROCESVERBAL

Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026
Data: 09.06.2026

Të pranishëm:

- Xhelal Dema, Nënkyetar i Komunës
- Vahid Hysenaj, Stacioni Policor – Kaçanik
- Aldi Blyta, FSK
- Fatmir Qaka, EVSB
- Elmihane Malsiu, HANDIKOS
- Naim Hysa, Kryqi i Kuq Komunal
- Ylber Tusha, Përfaqësues i bizneseve
- Diana Muhaxheri, Përfaqësuese e komunitetit
- Shqiponje Vogliqi Rexhepi, KLSP
- Emrin Dema, Këshilli i Prindërve
- Vedat Dema, Zyra për Barazi Gjinore
- Fidaim Fazliu, KBI
- Betim Shala, Komiteti për komunitete

Mbledhjen e kryesoi Nënkryetari i Komunës, z. Xhelal Dema.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Gjendja e sigurisë në periudhën ndërmjet dy takimeve;
3. Siguria në trafikun rrugor dhe hapësirat publike, identifikimi i pikave të rrezikshme, vendosja e sinjalizimit rrugor, ndriçimi publik dhe fushatat vetëdijesuese;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u paraqit për miratim dhe u miratua nga të pranishmit.

2. Gjendja e sigurisë në periudhën ndërmjet dy takimeve

Lidhur me situatën e sigurisë në periudhën ndërmjet dy takimeve, Nënkryetari i Komunës, z. Xhelal Dema, ia dha fjalën përfaqësuesit të Stacionit Policor në Kaçanik, z. Vahid Hysenaj.

Vahid Hysenaj – Situata e sigurisë në Komunën e Kaçanikut, në periudhën ndërmjet dy takimeve, ka qenë e qetë dhe pa ndonjë rast që ka cenuar sigurinë e qytetarëve, me përjashtim të disa rasteve të cilat kanë qenë të menaxhueshme.

Angazhimi ynë më i madh ka qenë në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe mund të themi se nuk kemi pasur asnjë incident serioz.

Emrin Dema – Unë vij nga Këshilli i Prindërve dhe, bazuar në informatat që kam, gjendja e sigurisë nëpër shkollë ka qenë e mirë, falë bashkëpunimit të mirë ndërmjet Stacionit Policor dhe institucioneve arsimore.

Drejtori i Arsimit nuk është i pranishëm në këtë takim, por dëshiroj ta paraqes një kërkesë të disa prindërve të Shkollës Fillore “Emin Duraku”, që cikli i ulët shkollor të zhvendoset në Dushkajë, ndërsa cikli i lartë të vazhdojë mësimin në qytet, për shkak se nxënësit e kësaj moshe, në disa raste, po shfaqin sjellje devijante.

Nënkryetari Xhelal Dema – Kërkesën mund ta përcjell te Drejtori i Arsimit, i cili mund ta shqyrtojë dhe të marrë vendimin e duhur.

Fidaim Fazliu – Më gëzon fakti që gjendja e sigurisë në këtë periudhë kohore ka qenë e qetë, falë bashkëpunimit të akterëve të sigurisë. Megjithatë, do të kërkoja nga Policia e Kosovës që të bëhen krahasime të periudhave sa i përket veprave kriminale.

Vahid Hysenaj – Në përgjithësi, rastet kriminale kanë shënuar rënie dhe, nëse vazhdohet me aktivitetet vetëdijesuese dhe veprimet e koordinuara me akterët e sigurisë, besoj se situata do të ndryshojë edhe më tej për të mirë.

Emrin Dema – Aktivitetet vetëdijesuese përmes ligjëratave të organizuara nga Policia e Kosovës besoj se kanë ndikuar dukshëm në sigurinë e nxënësve nëpër shkolla. Mendoj se këto aktivitete duhet të vazhdojnë, si nga Policia e Kosovës, ashtu edhe nga akterët e tjerë relevantë.

Nënkryetari Xhelal Dema – Shqetësuese është paraqitja e identitetit të personave të dyshuar për vepra kriminale në rrjetet sociale, kur dihet se Policia e Kosovës, gjatë raportimit fillestar, përdor vetëm inicialet e personave.

Më intereson të di se si këto rrjete sociale i marrin informacionet dhe si i publikojnë ato me emër dhe mbiemër.

Vahid Hysenaj – Raportet e Policisë janë publike dhe portalet i marrin këto informacione nga raportet e Policisë. Zakonisht publikohen informacionet për rastet më të rënda.

Kur informacionet kanë të bëjnë me të mitur, përdoren vetëm inicialet, ndërsa për personat e rritur përdoret emri dhe mbiemri. Edhe në rastet e dhunës në familje, identiteti i personave publikohet me initiale.

Informacionet nuk merren drejtpërdrejt nga Stacioni Policor, pasi raporti i dorëzohet nivelit rajonal. Portalet mund t'i marrin informacionet edhe nga burime joformale.

Fidaim Fazliu – Është për keqardhje që gazetaria profesionale nuk është duke u zhvilluar në nivelin e duhur. Lajmet nuk klasifikohen siç duhet dhe po shkaktohen lëndime të mëdha shpirtërore. Për këtë arsye, institucionet e sigurisë duhet të ndërmarrin masa ligjore ndaj portaleve të cilat nxisin pasiguri dhe shkaktojnë dëme.

3. Siguria në trafikun rrugor dhe hapësirat publike

Nënkryetari Xhelal Dema – Lidhur me këtë pikë, në mungesë të Drejtorit të Shërbimeve Publike, prezent është z. Arben Fera, zyrtar në këtë drejtori.

Arben Fera – Jemi në fazën e nënshkrimit të kontratave për ndriçimin publik dhe sinjalizimin rrugor. Këto ditë kemi pasur ankesa dhe kërkesa të shumta nga qytetarët, mirëpo procedurat administrative po e pamundësojnë veprimin e menjëhershëm.

Emrin Dema – Kam një kërkesë nga disa qytetarë të fshatit Bob që në rrugën “Vëllezërit Çaka”, afër shkollës, të vendoset një pengesë e shtrirë në rrugë, pasi nxënësit e frekuentojnë shpesh këtë rrugë dhe shpejtësia e automjeteve është shumë e madhe.

Fidaim Fazliu – Kanë filluar punimet për rregullimin e rrugës në Çarshinë e Vjetër dhe shpresoj se do të bëhet një zgjidhje e përhershme.

Më intereson të di nëse ka ndonjë afat kohor për përfundimin e këtyre punimeve, pasi jemi në periudhën kur fillojnë të vijnë mërgimtarët, ndërsa bizneset që operojnë në këtë hapësirë po kanë shumë vështirësi në zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Punimet janë duke u zhvilluar edhe përreth Xhamisë, ku po shkaktohet shumë pluhur.

Nënkryetari Xhelal Dema – Lidhur me këtë çështje, ne kemi pasur një takim me bizneset, të cilat kanë shprehur shqetësimet e tyre. Bazuar në informatat që kemi, punimet mund të zgjasin deri në një muaj dhe shpresojmë që, përmes këtij projekti, të përfitojnë edhe bizneset, pasi synojmë të bëhet një zgjidhje afatgjatë për këtë pjesë të rrugës.

Naim Hysa – Dëshiroj të paraqes një shqetësim të disa prindërve të cilët i dërgojnë fëmijët në çerdhen e fëmijëve në Kaçanik. Sipas tyre, gjendja përreth këtij institucioni është kaotike për shkak të mungesës së hapësirave të parkingut, duke krijuar edhe pasiguri për fëmijët që e frekuentojnë këtë institucion.

Fatmir Qaka – Afër çerdhes së fëmijëve, para disa ditësh, ka shpërthyer një gyp i kanalizimit dhe ujërat e zeza kanë vërshuar në këtë rrugë, duke shkaktuar edhe erë shumë të rëndë.

Më intereson të di nëse është ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me këtë problem.

Nënkryetari Xhelal Dema – Është e vërtetë se krijohet kaos i madh në hapësirat përreth objektit të çerdhes së fëmijëve, por edhe prindërit duhet t'i parkojnë automjetet në parkingjet që gjenden pak më larg objektit të çerdhes.

Arben Fera – Lidhur me problemin e kanalizimit në këtë rrugë është njoftuar kompania përkatëse dhe shumë shpejt pritet të bëhet sanimi i problemit.

Ka kërkesa të ndryshme nga qytetarët për vendosjen e pengesave të shtrira në rrugë. Për këto kërkesa ekziston një komision i përbashkët me Policinë e Kosovës, i cili i shqyrton kërkesat dhe vlerëson nëse vendosja e këtyre barrierave është e nevojshme.

Fatmir Qaka – Kohëve të fundit kanë ndodhur disa veprime nga individë të ndryshëm, të cilat kanë prekur edhe vlerat e çmuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç është rasti i tri shkronjave “UÇK” mbi Gurin e Shpuar dhe, së fundmi, rasti i fotografisë së Komandantit Agim Bajrami, e cila është gjetur në një deponi mbeturinash në Prishtinë.

Më intereson të di nëse janë identifikuar autorët dhe pse nuk ka pasur ndonjë reagim publik, si nga institucionet, ashtu edhe nga shoqatat e dala nga lufta.

Pyetja e dytë është për institucionet komunale dhe Policinë e Kosovës, lidhur me atë nëse është përgatitur ndonjë plan operativ për sezonin veror, ku pritët fluks i madh i automjeteve, por mund të ketë edhe raste të zjarreve.

Vahid Hysenaj – Ne, si Polici e Kosovës, e kemi përgatitur planin operativ për sezonin veror. Për këtë qëllim kemi bërë edhe reduktimin e pushimeve, me qëllim që të kemi numër të mjaftueshëm të zyrtarëve policorë për menaxhimin e situatave të ndryshme.

Nënkryetari Xhelal Dema – Shërbimi i Zjarrfikësve e ka planin e vet operativ dhe, me kapacitetet që ka në dispozicion, do të jetë në zbatim të planit. Për keqardhje, ky shërbim përballet me mungesë të stafit, ndërsa Komuna nuk është kompetente për rekrutimin e personelit në këtë institucion.

Diana Muhaxheri – Më intereson të di lidhur me zhurmën gjatë natës që krijohet nga kafiteritë. A kanë këto lokale një orar të përcaktuar deri në cilën kohë mund të punojnë dhe deri në çfarë niveli të zërit mund të jetë zhurma?

Problem tjetër janë edhe fëmijët që lëvizin me trotinetë nëpër rrugë.

Vahid Hysenaj – Lokalet e kanë të përcaktuar orarin deri në të cilin mund të punojnë, ndërsa për zhurmën që krijojnë mund të shqiptohen masa dhe gjopa për prishje të rendit dhe qetësisë publike.

Kemi shumë kërkesa, ankesa dhe vizita dhe, ndonjëherë, nuk arrijmë t'i mbulojmë të gjitha, por, në përgjithësi, komunikimin dhe bashkëpunimin me qytetarët e kemi shumë të mirë.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve i trajtojmë në maksimumin e mundësive tona, ndërsa ekzistojnë edhe mekanizma të tjerë, siç është Inspektorati Policor i Kosovës, i cili trajton ankesat përkatëse.

Aldi Blyta – Më vjen mirë që në këto takime hapen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve. Ne jemi të gatshëm për bashkëpunim të hapur me çdo akter, me qëllim të adresimit dhe zgjidhjes së problemeve që i preokupojnë qytetarët.

4. Të ndryshme

Pas diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët dhe pjesëmarrësit e takimit, u nxjerrën këto rekomandime:

REKOMANDIMET NGA TAKIMI I III-të I KKSB-së

Bazuar në diskutimet dhe shqetësimet e ngritura gjatë Takimit të III-të të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), u evidentuan këto rekomandime:

-Të vazhdohet bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Kosovës, institucioneve arsimore, Këshillit të Prindërve dhe akterëve të tjerë relevantë, me qëllim të parandalimit të dukurive negative dhe rritjes së sigurisë së nxënësve.

-Policia e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe akterët e tjerë të sigurisë, të vazhdojë me ligjëratat dhe aktivitetet vetëdijesuese për nxënësit, veçanërisht lidhur me parandalimin e dhunës, sjelljeve devijante dhe dukurive të tjera negative.

-Policia e Kosovës të shqyrtojë mundësinë e prezantimit të të dhënave krahasuese për veprat kriminale në periudha të ndryshme, me qëllim të krijimit të një pasqyre më të qartë mbi trendet e sigurisë në Komunën e Kaçanikut.

-Të shqyrtohet çështja e publikimit të identitetit të personave të përfshirë në raste policore në portale dhe rrjete sociale, duke respektuar legjislacionin në fuqi, të drejtat e personave dhe veçanërisht mbrojtjen e identitetit të të miturve dhe viktimave të dhunës në familje.

-Drejtoria përkatëse komunale të vazhdojë procedurat për përmirësimin e ndriçimit publik dhe vendosjen e sinjalizimit rrugor, duke i dhënë prioritet pikave të identifikuara si të rrezikshme.

-Të shqyrtohet nga komisioni përkatës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kërkesa për vendosjen e një pengese të shtrirë në rrugën “Vëllezërit Çaka”, afër shkollës në fshatin Bob, me qëllim të uljes së shpejtësisë së automjeteve dhe rritjes së sigurisë së nxënësve.

-Drejtoria përkatëse komunale të informojë dhe, sipas mundësive, të lehtësojë komunikimin me bizneset dhe qytetarët lidhur me dinamikën dhe afatet e përfundimit të punimeve në Çarshinë e Vjetër, duke pasur parasysh ndikimin e tyre në veprimtarinë e bizneseve dhe ardhjen e mërgimtarëve.

-Të shqyrtohet gjendja e komunikacionit dhe parkimit pranë objektit të çerdhes së fëmijëve në Kaçanik dhe të ndërmerren masa për rritjen e sigurisë së fëmijëve dhe prindërve që e frekuentojnë këtë institucion.

-Të vazhdohet zbatimi i planeve operative për sezonin veror nga Policia e Kosovës dhe Shërbimi i Zjarrfikësve, duke marrë parasysh rritjen e fluksit të automjeteve, numrin e shtuar të qytetarëve gjatë sezonit veror dhe rrezikun e paraqitjes së zjarreve.

-Të shqyrtohen mundësitë për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Shërbimit të Zjarrfikësve, duke marrë parasysh mungesën e stafit dhe nevojën për reagim të shpejtë gjatë sezonit veror.

-Të intensifikohet monitorimi i respektimit të orarit të punës dhe nivelit të zhurmës nga lokalet e gastronomisë, në mënyrë që të parandalohet prishja e rendit dhe qetësisë publike, veçanërisht gjatë orëve të natës.

-Të ndërmerren aktivitete vetëdijesuese dhe parandaluese për sigurinë e fëmijëve që përdorin trotinetë në rrugët dhe hapësirat publike, me qëllim të parandalimit të aksidenteve dhe rrezikimit të pjesëmarrësve në komunikacion.


-Të vazhdohet bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet Komunës, Policisë së Kosovës, FSK-së, institucioneve arsimore, komuniteteve, organizatave dhe akterëve të tjerë relevantë, me qëllim të parandalimit dhe adresimit në kohë të problemeve të sigurisë në bashkësi.

-Rekomandohet që çështjet e ngritura në këtë takim dhe zbatimi i rekomandimeve të përcjellen në takimet e ardhshme të KKSB-së, duke kërkuar informata për masat e ndërmarra nga institucionet dhe akterët përgjegjës.

Në përfundim të takimit, Nënkryetari i Komunës, z. Xhelal Dema, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin, bashkëpunimin dhe diskutimet e tyre në funksion të përmirësimit të sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Kaçanikut.

Procesmbajtës:

Fatmir Qaka



Kryesoi: Nënkryetari

z. Xhelal Dema

